



Deklaratë

Asambleja e Parë Kombëtare e të Rinjve nga Zonat Rurale

**“Me të rinjtë,
për të rinjtë,
nga vetë të rinjtë”**

11 Tetor 2023



DEKLARATË

ASAMBLEJA E PARË KOMBËTARE E TË RINJVE NGA ZONAT RURALE

Rreth 100 të rinj nga komunitete të ndryshme rurale të Shqipërisë u mblodhën së bashku në Asamblenë e Parë Kombëtare të të Rinjve nga Zonat Rurale, si tematikë prioritare e ngjarjes më të rëndësishme të advokacisë rurale me pjesëmarrje – Parlamenti i tretë Rural Shqiptar i mbajtur nga 11 deri më 13 tetor 2023. Ky takim kombëtar rinor shënoi një ngjarje të rëndësishme që vendos në qendër perspektivat e tashme dhe të ardhme të rinisë në komunitet rurale.

Asambleja hodhi dritë mbi realitetet e ndryshme në të cilën gjenden të rinjtë në zonat rurale, me fokus të veçantë mbi sfidat dhe nevojat si dhe aspiratat dhe endërrat e tyre për të ardhmen. Duke njohur rolin themelor të të rinjve në mbështetjen e komuniteteve rurale, bujqësisë dhe sigurisë ushqimore, Asambleja vendosi në qendër të vëmendjes një ndër çështjet më urgjente - migrimin e të rinjve nga zonat rurale, e cila paraqet edhe riskun më të lartë për qëndrueshmërinë e sektorit dhe jetës komunitare në zonat rurale.

Migrimi

Të rinjtë kanë një rëndësi të jashtëzakonshme për qëndrueshmërinë dhe zhvillimin e komuniteteve rurale, për bujqësinë si dhe për sigurinë ushqimore. Megjithatë, përgjithësisht ata e kanë humbur motivimin për të qëndruar në fshat dhe për të investuar në bujqësi dhe zhvillimin e komuniteteve rurale. Ata ndjehen të papërfaqësuar në strukturën e ekonomisë agrare dhe nuk e konsiderojnë qëndrimin në zonat rurale si një perspektivë të sigurt për të ardhmen e tyre. Përmirësimi i cilësisë së jetesës në zonat rurale mund ta bëjë fshatin tërheqës për të rinjtë për të qëndruar dhe investuar.

Ne i bëjmë thirrje të gjithë aktorëve zhvillimorë të punojnë ngushtësisht me të rinjtë për të rritur dëshirën e tyre për të kontribuar në vendin e tyre nëpërmjet mbështetjes dhe inkurajimit. Është me rëndësi të identifikohen dhe të krijohen mekanizmat dhe stimujt e duhur për të

rritur interesin e të rinjve për të qëndruar dhe për të zhvilluar potencialin e tyre në zonat rurale.

Infrastruktura rrugore, shërbimet shëndetësore dhe arsimore

Infrastruktura rrugore, shërbimet shëndetësore dhe arsimore janë baza e mirëqënies së komuniteteve rurale, pjesë e rëndësishme e të cilave janë dhe të rinjtë. Megjithatë, zonat rurale përgjithësisht karakterizohen nga akses i ulët në shërbimet publike bazë të tilla si: infrastrukturë rrugore, ndriçimi publik, mirëmbajtja e parqeve dhe hapësirave publike, hapësirat dhe aktivitetet sportive dhe kulturore. Emigrimi i stafit shëndetësor rëndon edhe më shumë këtë situatë në zonat e thella malore, ku banorët përballen me sfida të mëdha për të siguruar shërbimin shëndetësor. Mungesa e mundësive arsimore është një tjetër problem që prek veçanërisht të rinjtë e komuniteteve rurale të cilët

DEKLARATË

përballen me sfida në aksesin e arsimit të mëtejshëm përtej shkollimit të detyrueshëm.

Ne kërkojmë nga institucionet e qeverisjes vendore dhe qendrore të investojnë në infrastrukturën rrugore lidhëse të komuniteteve rurale, në kujdesin shëndetësor dhe edukimin si një qasje për të ndaluar shpopullimin e zonave rurale, dhe largimin e të rinjve nga fshatrat. Përmirësimi i aksesit në shërbimet publike bazë dhe përmirësimi i cilësisë së tyre do të sigurojë një cilësi jete më të mirë dhe më të qëndrueshme për rininë tonë në komunitetet rurale.

Punësimi, mundësitë ekonomike dhe cilësia e jetës

Të rinjtë në zonat rurale përballen me sfida të shumta që ndikojnë në dëshirën dhe gatishmërinë e tyre për të investuar në këto zona. Zhvillimi i sipërmarrjeve bujqësore është i lidhur ngushtë me pronësinë e tokës ose trashëgiminë e bizneseve familjare. Aksesin e kufizuar në tokë, procedurat burokratike dhe mungesa e mbështetjes financiare pengojnë aftësinë e të rinjve për t'u angazhuar në sipërmarrje.

Ne theksojmë rëndësinë e politikave dhe programeve mbështetëse për të rinjtë të formuluar në përputhje me nevojat e tyre, të cilat mund të ndihmojnë përfshirjen e të rinjve në bujqësi dhe zhvillim rural. Këtu përfshihen politika që sigurojnë akses në tokë, kredi dhe teknologji, si dhe edukim dhe trajnim për

ta, duke përfshirë uljen e taksave, rritjen e subvencioneve dhe rritjen e aksesit në kredi, për të inkurajuar sipërmarrjen dhe krijimin e vendeve të punës për të rinjtë në zonat rurale.

Mungesa e jetës sociale dhe e mundësive për shfrytëzimin e kohës së lirë janë të fenomene të pranishme në zonat rurale. Të rinjtë në zonat rurale ju duhet të punojnë më shumë orë në ditë, të angazhohen në më pak aktivitete shoqërore me miqtë dhe udhëtojnë më pak në krahasim me të rinjtë në zonat urbane. Një problem tjetër për të rinjtë e zonave rurale është mungesa e angazhimit social në praktika, aktivitete vullnetare etj.

Ne kërkojmë angazhimin e të gjithë aktorëve që punojnë në zonat rurale për të ndihmuar në rigjallërimin e jetës në zonat rurale, përmes investimeve në infrastrukturën sociale dhe nxitjes së aktiviteteve që përforcojnë ndërveprimin dhe animimin e grupeve komunitetare, institucioneve dhe sipërmarrjes.

Angazhimi politik dhe civil i të rinjve në zonat rurale

Pjesëmarrja e të rinjve në proceset politike dhe vendimarrje është e rëndësishme për hartimin dhe zbatimin e tyre në nivelin vendor. Megjithatë, angazhimi civil dhe pjesëmarrja politike mbeten në nivele shumë të ulëta në Shqipëri. Kjo lidhet me besimin e ulët të të rinjve në aftësitë e tyre për të ndikuar në përmirësimin e situatës në zonat rurale.

DEKLARATË

ASAMBLEJA E PARË KOMBËTARE E TË RINJVE NGA ZONAT RURALE

Mendësia patriarkale është pengesë e rëndësishme për pjesëmarrjen politike të vajzave. **Ekziston një mungesë e përgjithshme e proaktivitetit dhe ndjenjës së demotivimit tek të rinjtë kur bëhet fjalë për angazhimin qytetar dhe politik të tyre.**

Ne kërkojmë fuqizimin dhe përfshirjen e të rinjve në zonat rurale në proceset vendimmarrëse vendore dhe qendrore, duke mundësuar pjesëmarrjen dhe kontributin e tyre aktiv në zhvillimin e komunitetit dhe formimin e politikave.

Kjo deklaratë dëshmon se të rinjtë në zonat rurale nuk ju drejtohen institucioneve të qeverisjes vetëm me ankesa, por ata i kanë identifikuar qartë prioritetet dhe ndërhyrjet që duhet të ndërmerren për përmirësimin e mirëqenies së banorëve të zonave rurale.

Qendra Rurale e Rinisë siguron se do të vazhdojë të luajë një rol aktiv dhe të kontribuojë në proceset e zhvillimit rural dhe bujqësor me qëllim që këto të jenë të orientuara dhe të lidhura ngushtë me shqetësimet, interesat dhe prioritetet e të rinjve.

QENDRA E RINISË RURALE
Për Komunitete Rurale Dinamike
Email: ruralyouthhub@anrd.al
Website: <https://anrd.al/rreth-nesh-2/>
Facebook: [Rural Youth Hub Albania](#)
Rr. Qemal Stafa, Pazari i ri, pallati n74, kati
2, Tirana, Albania

DEKLARATË

ASAMBLEJA E PARË KOMBËTARE E TË RINJVE NGA ZONAT RURALE